

VENDIM
Nr.301, datë 24.5.2006

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E KAVAJËS TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Kavajës të qarkut të Tiranës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë).

2. Ndryshimet që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha